



Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e Prokurimit

Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e Prokurimit

Analizë krahasuese

Prishtinë, Maj 2024

Autorë: Albulena Nrecaj – Musliu, Arbër Kabashi

Ekipi i hulumtuesve: Arbër Kabashi, Leorentë Alija, Valmir Ilazi

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativa për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të organizatës Iniciativa për Progres - INPO. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe ajo nuk pasqyron qëndrimet e Rockefeller Brothers Fund.

Përkrahur nga:



Përmbajtja

1. Lista e Shkurtesave-----	5
2. Përmbledhje Ekzekutive-----	6
3. Metodologjia -----	7
4. Planifikimi i prokurimit vs. Realizimi-----	8
5. Kontratat e paplanifikuara -----	9
6. Performanca e ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit: pasqyra individuale-----	10
6.1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal -----	10
6.2. Ministria e Arsimit-----	12
6.3. Ministria e Bujqësisë-----	13
6.4. Ministria e Drejtësisë -----	14
6.5. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -----	15
6.6. Ministria e Ekonomisë -----	16
6.7. Ministria për Komunitete dhe Kthim-----	17
6.8. Ministria e Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Inovacionit -----	18
6.9. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-----	19
6.10. Ministria e Mbrojtjes-----	20
6.11. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-----	21
6.12. Ministria e Infrastrukturës -----	22
6.13. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës -----	23
6.14. Ministria e Punëve të Brendshme -----	24
6.15. Ministria e Shëndetësisë-----	25
6.16. Ministria e Zhvillimit Rajonal -----	26
6.17. Zyra e Kryeministrit-----	27
7. Konkluzione -----	29
8. Rekomandime-----	30
Aneks I: Pasqyrë e përgjithshme statistikore -----	31

I. Lista e Shkurtesave

AQP - Agjencia Qendrore e Prokurimit

AK - Autoritet Kontraktues

MAPL - Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MINT - Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MPJD - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores

MKK - Ministria për Komunitete dhe Kthim

KRPP – Komisionit Rrregullativ i Prokurimit Publik

ZKM – Zyra e Kryeministrit

2. Përmbledhje Ekzekutive

Përmbushja efikase dhe efektive e objektivave strategjike dhe institucionale të një ministrie apo institucioni publik në përgjithësi, në të shumtën e rasteve kërkon kontraktimin e shërbimeve nga furnitorët e ndryshëm përmes procedurave të prokurimit publik. Planifikimi i nevojave dhe punëve që kërkojnë të kontrahohen përmes prokurimit publik, është një proces i obligueshëm me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë për fushën e prokurimit publik dhe menaxhimin financiar. Përmbushjen e objektivave në mënyrë efikase dhe ofrimin e shërbimeve cilësore e determinon edhe një planifikim i mirë i prokurimit, i cili po ashtu siguron që edhe fazat e tjera të prokurimit, siç janë tenderimi dhe menaxhimi i kontratës të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, sigurisht edhe të garantojnë ruajtjen e vlerës për parandë publike.

Në këtë raport INPO ka analizuar dhe vlerësuar se sa i përmbahen planifikimit të prokurimit ministritë dhe zyra e kryeministrit të Republikës së Kosovës, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, respektivisht sa dhe çfarë kontrata kanë planifikuar, sa është vlera e tyre e planifikuar dhe çfarë kanë kontaktuar në realitet. Kjo analizë nuk përfshinë vlerësimin e planifikimit si proces por siç u tha më lartë, fokusohet vetëm në krahasimin mes planit vjetor të prokurimit dhe raportit të vjetor të kontratave të nënshkruara.

Gjetjet tregojnë se Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministritë dhe Zyra e Kryeministrit), gjatë vitit 2023 ka planifikuar të prokurojë gjithsej 935 aktivitete të prokurimit, 378 për furnizime, 314 për shërbime, 239 punë dhe 4 konkurse të projektimit. Bazuar në raportet vjetore të kontratave të nënshkruara, vërejmë se në total gjatë vitit 2023, këto institucione kanë realizuar gjithsej 336 aktivitete të prokurimit, të cilat kanë rezultuar me 489 kontrata.

Ndërkaq, gjatë vitit 2023, gjithsej janë nënshkruar nga këto institucione 952 kontrata.

Rreth 463 kontrata apo gjysma e kontratave në vlerë rreth 28 milion euro, janë lidhur pa qenë fare të planifikuara. Vetëm një numër i vogël i tyre kanë të justifikuar procedurën e inicimit pa planifikim.

Shprehur në përqindje niveli i implementimit të planit të prokurimit nga Zyra e Kryeministrit dhe të Ministrive është jo më shumë se 35.93%.

Një gjetje tjetër shqetësuese e që duhet adresuar në mënyrë imediate nga Ministritë është planifikimi i vlerës së parashikuar të kontratës. Në shumicën e tenderëve, vlera e parashikuar në plan të prokurimit, është diametralisht më e lartë se vlera e parashikuar gjatë fazës së inicimit të tenderëve dhe e kundërta. Po ashtu, ky ndryshim vërehet edhe në buxhetin e tyre.

Nga mbi 442 milion euro gjithsej të planifikuar për shpenzim përmes prokurimit nga ana e Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit, vetëm rreth 83 milion prej tyre janë kontraktuar, apo rreth 19%.

INPO rekomandon që Ministritë dhe Zyra e Kryeministrit të trajtojnë më prioritet gjetjet e këtij raporti në mënyrë që të përmirësohet planifikimi i prokurimeve të tyre dhe aktivitetet e tyre të prokurimit të jenë të bazuara në planifikim të mirëfilltë, përmes së cilit sigurohet ruajtja e vlerës për parandë, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve të kontraktuara.

3. Metodologjia

Hartimi i këtij raporti është bazuar në analizimin dhe krahasimin e dy dokumenteve strategjike të Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit në fushën e prokurimit publik, (i) Planin Vjetor të Prokurimit 2023 dhe (ii) Raportin e Kontratave të Nënshkruara Publike gjatë vitit 2023.

Plani vjetor i prokurimit për secilën ministri dhe Zyrën e Kryeministrit, është shkarkuar nga platforma elektronike e prokurimit publik [e-prokurimi](#), ndërkaq Raporti Vjetor i Kontratave të Nënshkruara është siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përmbajtja e këtij raporti është analizë krahasuese e aktiviteteve të prokurimit të planifikuara për vitin 2023 dhe atyre të realizuara apo që kanë rezultuar me lidhje të kontratës gjatë vitit 2023 të Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit. Analiza fokusohet në krahasimin e numrit të aktiviteteve të prokurimit të planifikuara sipas llojit dhe sipas vlerës së parashikuar të kontratës me numrin e kontratave të lidhura sipas llojit dhe sipas vlerës. INPO është shërbyer edhe nga platforma elektronike [e-prokurimi.rks-gov.net](#) me qëllim të verifikimit të të dhënave dhe krahasimit të tyre në raport me planifikimin dhe raportin e kontratave të nënshkruara.

Po ashtu, INPO ka analizuar llojin e procedurave të prokurimit të përdorura, kriterin për dhënie të kontratës dhe ka identifikuar top 5 kontratat më të shtrenjta të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, që janë pjesë e planit të prokurimit për vitin 2023 por që nuk janë inicuar.

Të gjitha të dhënat e tjera janë siguruar përmes platformës elektronike të prokurimit publik dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

4. Planifikimi i prokurimit vs. Realizimi

Qëllimi i planifikimit të prokurimit është zhvillimi i aktiviteteve prokuruese me efikasitet dhe eficiencë nga autoriteti kontraktues (tutje AK). Ruajta e vlerës për paranë, kontraktimi i shërbimeve cilësore dhe promovimi i konkurrencës së lirë dhe të barabartë brenda furnitorëve janë ndër qëllimet kryesore të rregullave të prokurimit publik, përmes së cilave AK-ja synon të përmbushë objektivat e saj institucionale të autorizuar sipas ligjit.

Planifikimi i prokurimit është hapi i parë në procesin e prokurimit. Ai definohet në dy kuptime: (i) si proces i planifikimit të blerjeve për një periudhë të caktuar kohore dhe (ii) si ndërrmarrje e veprimeve planifikuese për të blerje specifike apo plan për një aktivitet të caktuar të prokurimit. Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë (tutje LPP) rregullon në masë të mjaftueshme planifikimin e prokurimit dhe veprimeve që duhet të ndërmerren nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, sa i përket planifikimit një vjeçar të prokurimit. Sipas LPP-së, 15 ditë pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës të gjitha AK-të janë të obliguara ta përfundojnë Planin e Vjetor të Prokurimit për vitin respektiv fiskal, i cili ofron detaje të mjaftueshme rreth kontratave potenciale të furnizimit, shërbimeve apo punëve të cilat synon t'i realizoj AK-ja.¹ Ky plan i prokurimit gjithsesi se duhet të jëtë në përputhje me planifikimet buxhetore të AK-së dhe në përputhje me objektivat strategjike apo planin e punës së AK-së. Në të kundërtën, prokurimi i AK-së nuk mund të jetë efikas dhe eficient dhe nuk do të mundësojë realizimin e programit të punës.

INPO ka analizuar planin vjetor të prokurimit për vitin 2023 të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të Republikës së Kosovës dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara nga këto institucione respektivisht AK, për të vlerësuar sa i janë përmbajtur planit vjetor të prokurimit gjatë inicimit të aktiviteteve të prokurimit, respektivisht lidhjes së kontratave për furnizime, shërbime dhe punë të planifikuara.

Gjetjet tregojnë se të gjitha këto institucione së bashku kanë planifikuar që gjatë vitit 2023 të prokurojnë gjithsej 935 aktivitete të prokurimit, 378 për furnizime, 314 për shërbime, 239 punë dhe 4 konkurse të projektimit. Bazuar në raportet vjetore të kontratave të nënshkruara të këtyre AK-ve, vërejmë se në total gjatë vitit 2023, këto AK kanë realizuar gjithsej 336 aktivitete të prokurimit, të cilat kanë rezultuar me 489 kontrata². Shprehur në përqindje niveli i implementimit të planit të prokurimit nga Zyra e Kryeministrit dhe të Ministrive është jo më shumë se 35.93%.

Realizimi i Planeve të Prokurimit, 2023				
Aktivitetet e planifikuara	Aktivitete të realizuara	Diferenca	Kontrata të nënshkruara	%
935	336	-599	489	35.93%

¹ Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

² Shënim: Numri më i madh i kontratave në raport me aktivitetet e prokurimit të realizuara është si rezultat i aktiviteteve të cilat kanë qenë në ndara në lote.

Sa i përket vlerës së planifikuar të aktiviteteve të prokurimit dhe vlerës së kontratave të nënshkruara, INPO ka gjetur se ka një shpërputhje të madhe në mes tyre. Bazuar në planet e prokurimit të AK-ve respektive, vlera e parashikuar e gjithsej 935 aktiviteteve të prokurimit është parashikuar të jetë mbi 442 milion euro, ndërkaq vlera e 489 kontratave të nënshkruara është mbi 83 milion euro apo vetëm 18.98% e vlerës së planifikuar në total.

Realizimi i aktiviteteve të prokurimit sipas vlerës			
Vlera e Aktiviteteve të planifikuara	Vlera e kontratave të nënshkruara	Diferenca	%
442,267,200.94€	83,965,626.77€	358,301,574.17€	18.98%

INPO ka gjetur se të dhënat e vlerës së parashikuar të kontratave nuk përputhen me vlerën e aktiviteteve të iniciuara për tenderim. Në shumë raste, INPO ka gjetur se në Planin vjetor të prokurimit, vlera e parashikuar e aktiviteteve është shumë më e lartë se vlera e parashikuar e tyre gjatë inicimit të tenderit.³ Në raste të tjera vlera e tenderit të inicuar del të jetë me e lartë se vlera e parashikuar në planin e prokurimit.⁴ Raste të tilla të mospërputhjes së vlerës së parashikuar dhe vlerës së inicuar janë prezente pothuajse në secilën ministri, dhe në shumicën e rasteve vlera e parashikuar e aktiviteteve të iniciuara është diametralisht me e vogël se ajo e planifikuar me planin vjetor të prokurimit.

Megjithatë, INPO ka analizuar dhe ka llogaritur edhe aktivitetet e paplanifikuara por që janë inicuar nga Autoritetet Kontraktuese e të cilat rezultojnë me një numër më të lartë të kontratave të nënshkruara. Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se gjatë vitit 2023 janë nënshkruar gjithsej 952 kontrata.

5. Kontratat e paplanifikuara

Gjatë analizës së prokurimit të AK-ve INPO ka gjetur se pothuajse në të gjitha AK-të ka numër të konsiderueshëm të kontratave të lidhura pa qenë të planifikuara fare në planin vjetor të prokurimit. Rreth 48,63% e kontratave të nënshkruara nga të gjitha AK-të që janë fokus i kësaj analize, janë për aktivitete të prokurimit të cilat nuk janë planifikuara fare apo nuk figurojnë në plane të prokurimit të AK-ve respektive.

Gjithsej kontrata	Të planifikuara	Të paplanifikuara
952	489	463

Vlera e nënshkruar e të gjitha kontratave të paplanifikuara është mbi 28 milion euro.

Vlera e kontratave të paplanifikuara		
Numri i Kontratave	Vlera e kontratave të nënshkruara	Pjesëmarrja në totalin e kontratave të nënshkruara
463	28,281,421.86€	25.19%

³ Shembull: Aktiviteti i prokurimit “Rehabilitimi i rrugës Prekoc-Krileve” i AK – Ministria e Infrastrukturës, ka pasur vlerën e parashikuar në plan të prokurimit 650 mijë, ndërkaq është inicuar me 27 mijë e 750 euro.

⁴ Shih aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i çerdhes në Godanc – Shtime”, të Ministrisë së Arsimit, ku nga 450 mijë euro të planifikuara për këtë aktivitet, Ministria ka rritur këtë vlerë gjatë tenderimit në 550 mijë euro.

6. Performanca e ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit: pasqyra individuale

Në tabelën e mëposhtme INPO ka paraqitur të dhënat për secilën Ministri dhe Zyrën e kryeministrit duke përfshirë, numrin e aktiviteteve të planifikuara dhe vlerën e parashikuar të tyre, në raport me numrin e kontratave të nënshkruara (duke përfshirë kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara) dhe vlerën e tyre.

Autoriteti Kontraktues	Aktivitetet e planifikuara	Kontrata të nënshkruara	Vlera e parashikuar në Plan të Prokurimit	Vlera e kontratave të nënshkruara	% e vlerës
Ministria e Mbrojtjes	61	91	43,401,308.00€	10,041,742.5€	23.10%
Ministria e Punëve të Jashtme	41	46	1,930,040.00€	1,360,999.54€	70.46%
Ministria për Komunitete dhe Kthim	11	21	322,485.54€	506,638.39€	+57,1%
Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë	32	62	18,996,131.27€	792,499.26€	4.17%
Ministria e Arsimit	57	57	47,095,800.00€	12,669,080.4€	26.90%
Ministria e Punëve të Brendshme	140	93	42,474,154.26€	7,164,513.98€	16.86%
Ministria e Bujqësisë	43	56	6,053,875.52€	731,841.49€	12.08%
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	46	45	11,968,747€	3,430,190.04€	28.60%
Ministria e Infrastruktues	63	47	143,375,130.00€	45,519,487.88€	31.70%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	71	80	7,177,029.00€	1,245,003.45€	17.03%
Ministria e Drejtësisë	30	22	704,261.00€	2,896,167.45€	+ 311%
Ministria e Ekonomisë	52	13	8,345,035.00€	860,282.91€	10.30%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	21	19	91,595.00€	113,049.08€	+23.42%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	132	86	47,671,170.00€	5,039,825.84€	10.50%
Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal	17	18	5,957,798.00€	3,000,098.63€	50.30%
Ministria e Shëndetësisë	96	149	55,784,058.00€	16,092,395.0€	28.80%
Zyra e Kryeministrit	22	47	918,583.00€	783,210.34€	85.20%
TOTALI	935	952	442,267,200.00€	112,247,026.35€	25.37%

Tutje, në këtë raport janë të paraqitura të dhënat specifike për secilën AK, sa i përket planifikimit dhe realizimit të planit të prokurimit.

6.1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e e Administrimit dhe Pushtetit Lokal ka paraparë 17 aktivitete në vlerë totale 5,957,798.00€. Për 17 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 13 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 76.47%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali i kontratave të nënshkuara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
17	13	18
Diferenca	-4	

Në total, në raportin e prokurimit të MAPL për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 18 kontrata, apo një (1) më shumë se planifikimi. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezultojnë që 5 kontrata (apo 27.77%) janë kontrata të nënshkuara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023.

Krahasuar për nga vlera, rezultojnë se 18 kontratat kanë vlerë 3,000,098.63€.

Vlera totale e kontratave të nënshkuara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara përbën 50.3% të realizimit të Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkuara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkuara	përqindja
5,957,798.00€	3,000,098.63€	50.3%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se MAPL nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 2 kontrata të furnizimeve dhe 2 të shërbimeve më shumë se që ka planifikuar, ndërkaq nuk i ka inicuar fare 3 kontrata për punë të cilat i ka planifikuar gjatë vitit 2023.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
6	7	4	0	8	9	1	0
Diferenca				+2	+2	-3	

INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën më të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e MAPL-së. Tri aktivitetet e ilustruara në tablën e mëposhtme nuk janë inicuar nga MAPL për shkak se këto projekte janë pjesë e grantit të performancës që u jepet komunave dhe si të tilla janë inicuar nga Komunitatet përfituese si aktivitetet e prokurimit, por që Ministria i ka paraqitur në planifikim të prokurimit si aktivitetet që do t'i inicoj vet.

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
Bashkëfinancimi me donator për skemën e granteve të bazuara në performancën komunale	Punë	2,500,000.00€
Programi komunal për zhvillim të Infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër komunal	Punë	900,000.00€
Mbështetje për projekte infrastrukturore për komunitete në komunat e Republikës së Kosovës	Punë	800,000.00€

6.2. Ministria e Arsimit

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e Arsimit ka paraparë 57 aktivitete në vlerë totale 47,095,800.00€. Për 57 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 17 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 29.82%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali i kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
57	17	57
Diferenca	-40	

Në total, në raportin e prokurimit të Ministrisë së Arsimit për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 57 kontrata, aq sa janë paraparë në planifikim. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 40 kontrata (apo 70.17%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023.

Krahasuar për nga vlera, rezulton se 57 kontratat kanë vlerë 12,669,080.49€.

Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara përbën 26.90% të realizimit të Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	përqindja
47,095,800.00€	12,669,080.49€	26.90%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se Ministria e Arsimit nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 1 kontrata të furnizimeve dhe 3 për punë më pak se që ka planifikuar, ndërkaq sa i përket kontratave të llojit shërbime ka lidhur 7 më shumë se sa ka planifikuar.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
10	11	33	3	9	18	30	0
Diferenca				-1	+7	-3	3

Gjithashtu, Ministria e Arsimit ka nënshkruar edhe 3 kontrata në vlerë 152,700.00€ të llojit konkurs projektimi por që këto nuk përfshihen në raport të prokurimit.

Ministria e Arsimit gjatë vitit 2023 ka nënshkruar 13 kontrata që kanë të bëjnë me konsulencë individuale. Ministria e Arsimit kishte paraparë 8 milion euro për blerjen e teksteve shkollore për vitin 2023/2024 por ky aktivitet ishte anuluar ngase ishte ndryshuar mënyra e blerjes.

INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën më të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
Blerja e teksteve shkollore për fazen e dytë për vitin shkollor 2023-	Furnizim	8,000,000.00€

2024		
Dixhitalizim, pajisje me kompjuter, tabela smart e projektor	Shërbime	6,500,000.00€
Ndërtimi I shkollës fillore ne Prishtine	Punë	2,200,000.00€
Ndërtimi i shkollës se mesme profesionale ne Ferizaj, faza II	Punë	1,700,000.00€
Ndërtimi I shkollës fillore dhe të mesme të ulët në F. Kosovë	Punë	1,390,000.00€

6.3. Ministria e Bujqësisë

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e Bujqësisë ka paraparë 43 aktivitete në vlerë totale 6,053,875.52€. Për 43 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 25 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 58.13%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali i Kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
43	25	56
Diferenca	-18	

Në total, në raportin e prokurimit të Ministrisë së Bujqësisë për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 56 kontrata, apo trembëdhjetë (13) më shumë se planifikimi.

Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 31 kontrata (apo 55.35%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023. Krahasuar për nga vlera, rezulton se 56 kontratat kanë vlerë 731,841.49€.

Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara përbën 12.08% të realizimit të Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	Përqindja
6,053,875.52€	731,841.49€	12.08%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se Ministria e Bujqësisë nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 8 kontrata të furnizimeve dhe 8 për punë më pak se që ka planifikuar, ndërkaq sa i përket kontratave të llojit shërbime ka lidhur 29 më shumë se sa ka planifikuar. 35 nga 48 kontratat e llojit shërbime, janë konsulencë individuale.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
15	19	9	3	7	48	1	0
Diferenca				-8	+29	-8	1

Gjithashtu. Ministria e Bujqësisë ka nënshkruar edhe 1 kontratë në vlerë 259,457.84€ të llojit konkurs projektimi por që këto nuk përfshihen në raport të prokurimit. INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën me të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
Ndërtimi i Objektivit	Punë	945,000.00€
Konsolidimi i Tokave	Shërbime	480,000.00€

Programi Kombëtar për Inventarin e Tokave Bujqësore të Republikës së Kosovës, sipas kontratave Lot I dhe Lot 2	Punë	460,000.00€
Rehabilitimi i Rrjetit Rrugor të Zonave Vreshtare në Republikën e Kosovës (projekt kapital)	Punë	350,000.00€
Furnizimi me pajisje laboratorike si dhe ndarja dhe inventarizimi i laboratorit të mbetjeve kimike dhe laboratorit të mikrobiologjisë ushqimore	Punë	40,000.00€

6.4. Ministria e Drejtësisë

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e Drejtësisë ka paraparë 30 aktivitete në vlerë totale 704,261.00€. Për 30 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 11 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 36.66%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali i Kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
30	11	22
Diferenca	-19	

Në total, në raportin e prokurimit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 22 kontrata, apo tetë (8) më pak se planifikimi. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 11 kontrata (apo 50%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023. Krahasuar për nga vlera, rezulton se 22 kontratat kanë vlerë 2,896,167.45€. Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara tejkalon për 311% realizimin e Planit të Prokurimit për nga vlera.

Arsye e kësaj rritje të vlerës së kontraktuar në krahasim me vlerën e parashikuar në planifikim janë dy kontrata për përfaqësim ligjor të inicuar nga Ministria e Drejtësisë e që nuk ishin pjesë e planifikimit, për shkak se kanë qenë jashtë parashikimeve të Ministrisë për shkak të natyrës së lëndës së tyre, e që vlera e tyre është 1.2 milion Euro.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	përqindja
704,261.00€	2,896,167.45€	+ 311%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se Ministria e Drejtësisë nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 8 kontrata të furnizimeve dhe një për punë më shumë se sa ka planifikuar, 9 kontrata për shërbime më pak se që ka planifikuar.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
14	15	1	0	14	6	2	0
Diferenca				+8	-9	+1	0

INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën më të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
Servisimi, kalibrimi dhe validimi i certifikuar i instrumenteve GC-MS dhe HS-GC FID të Laboratorit të Toksikologjisë	Shërbime	75,000.00€
Furnizim me material shpenzues për laboratorin e histopatologjisë	Furnizim	65,000.00€
Furnizim me material shpenzues laboratorik për laboratorin e Toksikologjisë	Furnizim	55,000.00€
Furnizim me pajisje IT	Furnizim	43,000.00€
Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes Furnizim me materia zyrtar	Furnizim	41,521.00€

6.5. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka paraparë 71 aktivitete në vlerë totale 7,177,029.00€. Për 71 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 46 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 64.78%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali i Kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
71	46	80
Diferenca	-25	

Në total, në raportin e prokurimit të MFPT për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 80 kontrata, apo nëntë (9) më shumë se planifikimi. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 34 kontrata (apo 42.50%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023.

Krahasuar për nga vlera, rezulton se 80 kontratat kanë vlerë 1,245,003.45€. Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara përbën 17.03% të realizimit të Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	përqindja
7,177,029.00€	1,245,003.45€	17.03%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se MFPT nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 4 kontrata të furnizimeve më pak se sa ka planifikuar, 10 kontrata për shërbime dhe 3 kontrata për punë më shumë se që ka planifikuar.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
33	35	3	0	29	45	6	0
Diferenca				-4	+10	+3	

INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën më të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e MFPT.

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
Zhvillimi i sistemit për deponimin e te dhenave (dataëarehouse), integrimin e sistemeve te MF. (Avancimi-mirmbajtja e sistemit te tatimit ne pronë; avancimimi Imirmbajtja sistemeve PIP- BDMS; Avancimi- mirmbajtja e sistemeve te skemave sociale e pensionale)	Shërbime	3,509,452.00€
Ndertimi i shtëpive rezidenciale për personat e moshuar	Punë	1,000,000.00€
Avansimi ,mirmbajtja e sistemit te borxheve CS-DRM	Shërbime	300,000.00€
Mbështetje mirëmbajtje dhe licencat Oracle softtëare Uptade Licence & Suport Sipas nevojave të Thesarit	Shërbime	180,000.00€
Mirmbajtje dhe produkte bankare për nevojat e Thesarit të Kosovës dhe organizatave buxhetore.	Shërbime	150,000.00€

Tri aktivitetet e fundit të paraqitura në tabelën e mësipërme janë aktivitete që me vendim të ministrit të financave në korrik të 2023, i janë autorizuar Agjencisë Qendrore të Prokurimit për tu inicuar.

6.6. Ministria e Ekonomisë

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e Ekonomisë ka paraparë 52 aktivitete në vlerë totale 8,345,035.00€. Për 52 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 6 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 11.53%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali i Kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
52	6	13
Diferenca	-46	-39

Në total, në raportin e prokurimit të Ministrisë së Ekonomisë për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 13 kontrata, apo 39 më pak se planifikimi. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 7 kontrata (apo 53.84%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023.

Krahasuar për nga vlera, rezulton se 13 kontratat kanë vlerë 860,282.91€. Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara përbën 10.30% të realizimit të Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	Përqindja
8,345,035.00€	860,282.91€	10.30%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se Ministria e Ekonomisë nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 31 kontrata të furnizimeve, nga 4 kontrata për shërbime dhe punë më pak se sa ka planifikuar.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
36	12	4	0	5	8	0	0
Diferenca				-31	-4	-4	

INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën me të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e Ministrisë së Ekonomisë.

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
SHËR.E NDRYSH.INTEL.&KËSHILLDH (Perkthim,Lektorim dhe Shërbime Linguistike Gjuhesore	Shërbime	2,806,697.00€
Programi i zbatimit te masave te EE	Punë	1,700,000.00€
Implementimi i Rrjetit të pavarur jo publik Pilotimi 5G	Shërbime	1,400,000.00€
Renovimi i Nderteses se QED	Punë	900,000.00€
Krijimi i CERT-it Sektorial për sektorin e Energjisë	Shërbime	252,250.00€

6.7. Ministria për Komunitete dhe Kthim

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka paraparë 11 aktivitete në vlerë totale 322,485.54€. Për 11 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 9 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 81.81%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali I Kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
11	9	21
Diferenca	-2	

Në total, në raportin e prokurimit të MKK për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 21 kontrata, apo 10 më shumë se planifikimi. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 10 kontrata (apo 47.61%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023.

Krahasuar për nga vlera, rezulton se 21 kontratat kanë vlerë 506,638.39€. Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara tejkalon për 57.1% realizimin e Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	përqindja
322,485.54€	506,638.39€	57.1%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se MKK nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur nga 5 kontrata për furnizime dhe shërbime më shumë se sa që ka planifikuar.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
4	7	0	0	9	12	0	0
Diferenca				+5	+5		

INPO ka identifikuar aktivitetet e prokurimit me vlerën me të lartë të parashikuar të kontratës të cilat nuk janë inicuar nga ana e MKK.

Titulli i aktivitetit të Prokurimit	Lloji	Vlera e parashikuar në Plan
Mirëmbajtja e databazes per personat e zhvendosur	Shërbime	10,000.00€
Servisimi i automjeteve te MKK-se	Shërbime	Nuk ka çmim

6.8. Ministria e Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Inovacionit

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2023, Ministria e Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Inovacionit ka paraparë 32 aktivitete në vlerë totale 18,996,131.27€. Për 32 aktivitetet e planifikuara janë arritur që të inicohen dhe nënshkruhen 12 kontrata, shprehur në përqindje, realizimi i planit të prokurimit për nga numri i aktiviteteve është 37.5%.

Planifikimi vs. Realizimi		Totali I Kontratave të nënshkruara
Plani i prokurimit 2023	Kontratat e planifikuara	Gjithsej kontrata
32	12	62
Diferenca	-23	

Në total, në raportin e prokurimit të MINT për vitin 2023 figuron se janë lidhur janë gjithsej 62 kontrata, apo 30 më shumë se planifikimi. Pra, duke u bazuar në raportin e prokurimit të vitit 2023 rezulton që 51 kontrata (apo 82.25%) janë kontrata të nënshkruara të cilat nuk bëjnë pjesë në planifikimin e prokurimit 2023.

Krahasuar për nga vlera, rezulton se 62 kontratat kanë vlerë 792,521.54€. Vlera totale e kontratave të nënshkruara duke përfshirë edhe kontratat e planifikuara dhe ato të paplanifikuara përbën 4.17% të realizimit të Planit të Prokurimit për nga vlera.

Vlera e parashikuar në Plan, Raport dhe vlera e kontratave të nënshkruara		
Vlera e parashikuar në Plan	Vlera e kontratave të nënshkruara	Përqindja
18,996,131.27€	792,521.54€	4.17%

Sa i përket llojit të kontratave të planifikuara INPO ka gjetur se MINT nuk i është përmbajtur planifikimit, duke lidhur 14 kontrata për furnizime, 13 kontrata për shërbime dhe 3 kontrata për punë më shumë se sa që ka planifikuar.

Lloji i kontratave në Plan dhe Raport							
Plan të prokurimit				Raport			
Furnizim	Shërbime	Punë	Konkurs	Furnizime	Shërbime	Punë	Konkurs
10	20	2	0	24	33	5	0
Diferenca				+14	+13	+3	

